

**STATUTI**

**I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"METRO TRAVEL" SHPK**

**TITULLI I  
DISPOZITA THEMELORE**

**Neni 1**

1. Bazuar ne legjislacionin ne fuqi, konkretisht ne ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ne dispozitat e Kodit Civil, si dhe ne zakonet e mira tregetare, sipas mareveshjes se ortakeve dhe aktit të themelimit te hartuar sipas vullnetit te tyre, hartohet ky Statut per rregullimin normativ te funksionimit te Shoqerise Tregtare.

**Neni 2**

1. Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine ne baze te ketij statuti, do te jete shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe do te ushtroje aktivitetin e saj ne Republiken e Shqiperise ne baze te regjistrimit te institucioneve tatimore dhe ne regjistrat tregtare Shqiptare, si dhe jashte saj ne baze te modaliteteve ligjore qe kerkohen nga shteti ku do te ushtroje veprimtarine.

**Neni 3**

1. Per efekt te regjistrimit dhe te gjitha modaliteteve te tjera ligjore Shoqeria do te quhet "METRO TRAVEL" Shpk.

**Neni 4**

1. Selia ligjore dhe administrative e "METRO TRAVEL" Shpk, ndodhet ne Korçë, lagja Nr 7, rruga "Ismail Qemali". Nr pasurie 1/89-N 26 Nr kadastral 8564  
2. Ajo mund te ndryshoje seline, te krijojë dege dhe zyra perfaqesimi, ne Shqiperi ashtu dhe jashte saj ne perputhje me ligjin dhe me vendim te Asamblese se pergjithshme.

**Neni 5**

1. Shoqeria " METRO TRAVEL" Shpk, do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar per nje periudhe te papercaktuar nga afate kohore, qe fillon ditën e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar.



2. Kohezgjatja e aktivitetit të shoqërisë mund të kufizohet me afate kohore, mund të shkurtohet, ose aktiviteti i shoqërisë mund të nderpritet teresisht dhe menjëherë, me vendim të Asamblesë së përgjithshme.

#### Neni 6

1. Shoqëria "METRO TRAVEL" Shpk, do të ketë objekt të aktivitetit të saj;
  - a) transport rrugor kombëtar dhe nderkombëtar udhëtarësh.
  - b) agjensi udhëtimi dhe turistike brenda dhe jashtë vendit.
  - c) agjenti turistik.
  - d) transport të mallrave brenda dhe jashtë vendit.
  - e) eksport/import dhe tregtim të artikujve industriale dhe ushqimore.
  - f) ushtrimin e aktiviteteve bar/restorat dhe hotel.
  - g) tregtim me shumicë e pakicë të pijeve alkoolike dhe joalkoolike.
  - h) import dhe tregtim të automjeteve dhe makinerive të ndryshme
2. Me vendim të asamblesë së përgjithshme, brenda kufijve të konform modaliteteve të lejuara nga legjislati, mund të bëhet ndryshimi, shtimi ose pakësimi i aktiviteteve që përbejnë Objektin e shoqërisë.

## TITULLI II KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

#### Neni 7

1. Kapitali themeltar i shoqërisë "METRO TRAVEL" Shpk, përbehet prej shumës 100.000 (njëqind mijë) leke të reja, të kontribuara nga ortakët e vetëm Shoqëria "METRO EURO" Shpk, me numër Nipti L08526001T.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë "METRO TRAVEL" Shpk, ndahet në 1000 (njemijë) kuota me vlerë 100 (njëqind) leke secila.
3. Kuotat e kapitalit themeltar, zotërohen 100 % (njëqind për qind) nga ortakët e vetëm Shoqëria "METRO EURO" Shpk, me numër Nipti L08526001T.
4. Shoqëria tregtare mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

#### Neni 8

1. Nuk mund të pranohet në këtë shoqëri si ortak një person i tretë pa pëlqimin e ortakëve.
2. Nuk mund të hiqet dorë nga kjo shoqëri në mënyrë të njëanshme pa pëlqimin e ortakëve të tjerë.
3. Ortakët që dëshirojnë të shesin kuotat e tyre të kapitalit në këtë shoqëri është i detyruar që oferten e tyre për shitje t'ua bëjë ortakëve të tjerë dhe nëse këta të fundit

Nënshkrimet e ortakëve themelues  
Metro Euro Shpk (Përfaqësuar nga Administratori)  
Endri Shuri



nuk pranojne te blejne, ose nuk japin pergjigje brenda 30 diteve nga dita e berjes se ofertes, vetem ateherë ortaku eshte i lire qe te shese lirisht pjesen e tij.

4. Ne rast te rritjes se vlerave te kapitalit themeltar te shoqerise vlerat e kapitalit fillestar nuk rivleresohen.

5. Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferushme dhe te tregetushme ne gjini konform ligjit.

6. Kuotat e kapitalit themeltar jane lirisht te kalueshme ndermjet ortakeve.

7. Transferimet e kuotave te kapitalit, per efekt vlefshmerie duhet te behet me akt noterial, te regjistrohesh ne librat e shoqerise dhe te depozitohesh ne sportelet e Qendres Kombetare te Regjistrimit.

8. Kalimi i kuotave, nga nje ortak tek te tretet jo ortake, duhet te behet me miratim nga Asambleja e pergjithshme.

### Neni 9

1. Kuotat e ortakeve, mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.

2. Dispozitat e nenit 8 të këtij statuti, për kalimin e kuotave zbatohen edhe për kalimin e pjesëve të kuotave.

### Neni 10

1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

### Neni 11

1. Veprimet e kryera ne kundërshtim me rregullat e percaktuara ne nenet 8 deri ne 10 te ketij statuti jane te pavlefshme.

2. Nese per lajthitje te ç'faredolloji, kalimi i pjeseve te kapitalit themeltar i bere ne kundërshtim me keto rregulla regjistrohesh ne librat e shoqerise dhe/ose ne regjistrin tregtar, çdo person i interesuar mund te kerkoje anulimin e ketyre veprimeve per pavlefshmeri ne baze te ligjit.

## TITULLI III MARRËDHËNIET NDËRMJET SHOQËRISË DHE ORTAKËVE

### Neni 12

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.



2. Fitimi u shpërndahet ortakëve ne menyre te barabarte, në raport me kuotat e zotëruara.

### Neni 13

1. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

2. Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojë këtë certifikatë.

3. Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

### Neni 14

1. Administratori, i cili nga pakujdesia lëshon një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 13 të këtij statuti, përgjigjet personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

2. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, sipas pikës 1 të nenit 13 të këtij statuti, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

### Neni 15

1. Paditë e shoqërisë, siç parashikohet në nenin 14 të këtij statuti, mund të ngrihen edhe sipas pikës 3 të nenit 10 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare"

2. Parashkrimi i padive, sipas pikës 1 të këtij neni, nis në datën kur është kryer shpërndarja e ndaluar.

## TITULLI IV ORGANET E SHOQËRISË

### KREU I ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neneshkrimet e ortakëve themelues  
Metro Euro Shpk (Perfaqesuar nga Administratori)  
Endri Shuri



## Neni 16

1. Asambleja e përgjithshme është organi suprem i Shoqërisë "METRO TRAVEL" Shpk.

2. Asambleja e përgjithshme, perbehet nga te gjithë ortakët me te drejte vote te pranishem ne mbledhjen perkatese.

3. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) ndryshimet e statutit;

c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga statuti.

4. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 3 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

## Neni 17

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në seanca te zakonshme te pakten nje here ne vit dhe sa here që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 19 të këtij statuti.

3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Neneshkrimet e ortakëve themelues

Metro Euro Shpk (Perfaqesuar nga Administratori)

Endri Shuri

5



5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

7. Dispozitat e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohen nëse blerjet, sipas pikave 4 e 5 të këtij neni, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu.

8. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorit.

### Neni 18

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 19

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorit një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 18 të këtij statuti.

2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratori njofton përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 18 të



këtij statuti.

4. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

## Neni 20

1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## Neni 21

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 22 të këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 23 të këtij statuti.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.


## Neni 22

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 21 të këtij statuti për:

- a) ndryshimin e statudit;
- b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- c) shpërndarjen e fitimeve;
- d) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

2. Për çështjet e tjera që nuk përcaktohen në pikën 1 të këtij neni, të renditura në pikën 3 të nenit 16 të këtij statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

3. Vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.



## Neni 23


1. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
2. Ortaket, që nuk janë të pranishëm, mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
  - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
  - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
  - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.
5. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky statut, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

## Neni 24

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - c) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 25

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
2. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.





5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratori, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, është i detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

## Neni 26

1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

2. Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, apo një vlerë më të vogël të parashikuar në statut dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

3. Kur asambleja e përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçëm dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçëm në mënyrën e duhur, ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.

4. Kur gjykata pranon kërkesat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij neni, shoqëria përballon kostot e emërimit dhe të shpërblimit të ekspertit të emëruar për kryerjen e hetimit të posaçëm.

5. E drejta për të kërkuar hetim të posaçëm, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, duhet të ushtrohet brenda 3 vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit të themelimit, si dhe brenda 3 vjetëve nga data e veprimit, që konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

6. Kreditori, që në keqbesim paraqet një kërkesë, sipas pikës 2 të këtij neni, përgjigjet në përputhje me nenin 34 të Kodit të Procedurës Civile.

## Neni 27

1. Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorit, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit.

2. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë, ose një vlerë më të vogël të parashikuar në statut, apo secili prej kreditorëve të shoqërisë mund t'i kërkojnë asamblesë së përgjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë



padi drejtpërdrejt përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

3. Në rastet kur shoqëria ngre padi si më sipër, ajo merr pjesë në gjykim me anë të një përfaqësuesi të posaçëm, të caktuar nga asambleja e përgjithshme.

4. Ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara se përfaqësuesi i emëruar nga asambleja e përgjithshme mund të mos ngrejë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.

5. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçëm për korrigjimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacenuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 12 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

6. Ortakët në pakicë dhe kreditorët e përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur asambleja e përgjithshme nuk merr vendim, ose refuzon të vendosë për kërkesën e tyre për ngritjen ndaj administratorëve të padisë, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si vendim i paligjshëm, apo për ngritjen e padive të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorit apo ortakëve.

7. Dispozita e paragrafit të gjashtë të nenit 26 të këtij statuti zbatohet edhe për këto padi.

## Neni 28

1. Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

## Neni 29

1. Vendimet e asamblesë së përgjithshme nuk mund të cenojnë të drejtën e ortakëve ose të kreditorëve për të kryer veprimet e parashikuara në nenet 26, 27, e 28 të këtij statuti.


## KREU II ADMINISTRATORI

### Neni 30

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si

Neneshkrimet e ortakëve themelues  
Metro Euro Shpk (Përfaqësuar nga Administratori)

Endri Shuri



administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është për 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2. Në bazë të disponimeve të tyre fillestare ortaket themelues emerojnë për një mandat 5 vjeçar, si administrator të shoqërisë "METRO TRAVEL" Shpk, shtetasin Leonard Belortaja, i datëlindjes 16.10.1976, mbajtës i dokumentit identifikues letërnjoftim me numer 025349537.

3. Administratori i shoqërisë tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

4. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqese këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) punesimin e personelit të administratës, duke përcaktuar kushtet e kontratave të punës.

f) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në statut.

5. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 17 të këtij statuti, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblesë e përgjithshme.

6. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

7. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.


### Neni 31

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundërvihen

Neneshkrimet e ortakeve themelues

Metro Euro Shpk (Përfaqësuar nga Administratori)

Endri Shuri



palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

2. Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.

3. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

### Neni 32

1. Shpërblimit bazë të administratorit mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorit përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

2. Shpërblimi, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorit dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

3. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorit në masën e përshtatshme.

4. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

### Neni 33

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;


ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

dh) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyres të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel



standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me te kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejojn që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jape kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 27 të këtij statuti zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

## TITULLI V AKTIVITETI DHE KONTROLI FINANCIAR I SHOQERISE

### Neni 34

1. Viti financiar i shoqërisë "METRO TRAVEL" Shpk, fillon me date 01 janar te çdo viti dhe perfundon me date 31 dhjetor te po atij viti.


### Neni 35

1. Aktiviteti financiar i shoqërisë mund te kontrollohet nga ekspertet kontabel te autorizuar nga Asambleja e pergjithshme.

2. Ne vendimin e asamblese se pergjithshme, per emerimin e eksperteve kontabel percaktohen:

- a) detyrat;
- b) kufijte e kompetences;
- c) kohezgatja e emerimit;
- ç) masa e shperblimit;
- d) sipas rastit edhe afati per pergatitjen e raportit te kontrollit;

### Neni 36



1. Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet nga detyra me vendim te asamblese kur:

- a) nuk ka permbushur detyrat e percaktuara brenda afateve;
- b) vertetohet se ka konflikt interesi;
- c) ka kryer veprime ne dem te shoqerise, apo ka perfituar padrejtesisht nga aktiviteti i shoqerise;
- ç) i eshte hequr e drejta per te ushtruar profesionin e tij;
- d) ka shkelur sekretin profesional te shoqerise;
- e) kur me vendim te asamblese se pergjithshme, vendoset qe sherbimi i ekspertit kontabel nuk eshte me i nevojshem;

## TITULLI VI PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

### KREU I PRISHJA E SHOQËRISË

#### Neni 37

1. Shoqëria "METRO TRAVEL" Shpk, prishet:
- a) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
  - d) me vendim të gjykatës;

#### Neni 38

1. Administratori regjistron prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim.

#### Neni 39

1. Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë "METRO TRAVEL" Shpk, ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".



**KREU II**  
**LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE**  
**Neni 40**

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit.

3. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

4. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

5. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

6. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

**Neni 41**

1. Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;

b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;

c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose

ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

3. Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi



të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

5. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

6. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

#### **Neni 42**

1. Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

2. Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

e-mail [info@metroeuro.al](mailto:info@metroeuro.al)

#### **ORTAKET THEMELUES**

**Shoqëria "METRO EURO" Shpk**  
**Nipt: L08526001T**

**Perfaqësuar nga Administratori**  
**Endri SHURI**

